

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Lokalet" në Kosovë do të sjellin ndryshim pushteti në veri – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/lokalet-ne-kosove-do-te-sjellin-ndryshim-pushteti-ne-veri/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 09:21:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 tetor 2025, 07:26:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	371749874ba3b012258ad87e0d2847a7153a1c2c8bd96f879f238530bb2cd4f2
TEKSTI	dc70591a5364f112a0b53a6956daefb36e0c64c317a76bb6159798f2b3ed4cf3
PAMJA	a6aca3b975fa270483c8373537a2db72a2918c5d43786009c4127082e9e9d571

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	04713795f4933970904b93a6775d1a485993dfc75df9b191b1368eabb2bc7852
E MËPARSHMJA	6ce41ee1a3a064aead25f20ecc64b4ee96c876b367d1eb1a9592ac415befba60
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/04713795f4933970904b93a6775d1a485993dfc75df9b191b1368eabb2bc7852>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Studentja 23-vjeçare Milena Jevtiç nga Mitrovica e Veriut perballlet me keto ndryshime çdo ditë. Pas tre vitesh bojkot zgjedhjesh, partitë serbe do të marrin pjesë në zgjedhjet lokale më 12 tetor. Milena nuk do të votojë, duke parë se asnjë parti nuk mund të sjellë ndryshime reale, megjithatë beson se shumica e serbëve të Kosovës do ta bëjnë. “Edhe nëse serbët kthehen në udhëheqjen lokale, nuk shoh ndonjë përmirësim real,” thotë ajo.

Shumë serbë të Kosovës presin që Lista Serbe të fitojë zgjedhjet e ardhshme lokale në Veri. Ndërsa parashikimet tregojnë këtë rezultat, Miodrag Marinković, drejtor ekzekutiv i OJQ CASA në Mitrovicën e Veriut, thotë se pavarësisht partisë, “përfaqësuesit politikë të komunitetit serb do të formojnë me shumë gjasa qeverinë lokale.”

“Çfarë do të ndryshojë është se komuniteti do të ketë një shprehje të vërtetë demokratike,” shton ai. “Lista Serbeas nuk e ka përfaqësuar plotësisht interesin e serbëve më parë, por tani ndikimi i Prishtinës mbi çështjet lokale do të reduktohet dhe vetëqeverisja lokale mund të funksionojë në interes të komunitetit.”

Nga perspektiva shqiptare, zgjedhjet shënojnë një realitet të ri për partitë serbe. Analisti politik Nexhmedin Spahiu e sheh këtë si legjitimizim të masave të qeverisë së Kurtit.

“Nuk besoj se do të ketë ndonjë ndryshim; përkundrazi, marrja e kontrollit mbi veriun do të legjitimohet. Serbët do të qeverisin vetë, por kjo nuk do të sjellë asnjë rezultat apo zhvillime të mëtejshme. Situata nuk mund të kthehet më siç ka qenë para incidentit të Banjskës”, thotë Spahiu.

Shpesh, qeveria e Kosovës dhe qeveritë lokale vendos burg pa afat për gjashtë të...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

Flamujt dhe simbolet si shkak i konfliktit

Të gjitha tensionet e fundit kanë filluar nga simbolet. Në targat e makinave apo pasaportat, këto simbole të vogla kanë shkaktuar përplasje të mëdha. Bllokime rrugësh, pika kalimi kufitar u mbyllën dhe presidenti i Serbisë dërgoi ushtrinë në kufi. Për Miodrag Marinković, rreziku i tensioneve fillon me ndryshimet e pushtetit.

“Konflikti i parë që parashikoj do të jetë mbi simbolet, si vendosja e flamurit serb në ndërtesat komunale dhe përfshirja e policisë në atë proces.” Ai shton gjithashtu: “Që nga fillimi, veprimet e qeverive të reja lokale do të hasin rezistencë të fortë nga Prishtina, e mbështetur nga forcat policore, dhe hapat e parë të asambleve lokale do të shoqërohen me tensione dhe përplasje.”

Nga ana tjetër, Nexhmedin Spahiu mendon se vetëqeverisja lokale mund të rivendosë grafitet dhe gjithçka që bën pjesë në kompetencat komunale.

“Ato mund t’i rikthejnë përsëri. Edhe nëse janë simbole nacionaliste, kjo është thjesht një çështje interpretimi ligjor, dhe ligji nuk mund të interpretohet në mënyrë subjektive. Kemi situata të ngjashme në pjesë të tjera të vendit, kështu që kjo mund ta relativizojë çështjen,” thotë Spahiu.

DW kontaktoi qeverinë e Kurtit për të pyetur mbi tensionet e mundshme pas ndryshimeve të pushtetit pas zgjedhjeve, por nuk mori përgjigje. Përfaqësuesit e Listës Serbe gjithashtu u kontaktuan, por nuk u përgjigjën.

Përfaqësuesit e partive opozitare serbe në Kosovë, si Stefan Veljkovic nga Partia Demokratike Serbe, kritikojnë të gjitha vendimet e Kurtit, por edhe politikën e Listës Serbe. Ai thotë se partia e tij “do të kryejë një rishikim të plotë të institucioneve komunale, veçanërisht të atyre në pozicione të larta (si drejtorë), dhe do të anulohet të gjitha vendimet dëmtuese që ndikojnë negativisht tek popullsia lokale.”

Zgjedhjet në sy të qytetarëve

Zgjedhjet lokale në pjesë të tjera të Kosovës dominohen nga diskutime mbi infrastrukturën, çerdhet, parkun dhe në Prishtinë situatën e trafikut. Për shqiptarin Selim Sherifi, pritshmëritë për zgjedhjet e ardhshme janë të vogla.

“Ka shumë premtime, por si gjithmonë, shumica mbeten vetëm në letër. Katër vite po kalojnë dhe shohim pak ndryshime,” thotë Sherifi.

Vendimet politike dhe tensionet e vazhdueshme kanë shkaktuar largimin masiv të serbëve nga Veriu. Sipas raportit të International Crisis Group (ICG), nga 2015 deri në 2023, popullsia serbe në Kosovë ka rënë nga 145.000 në 100.000.

Edhe Milena Jevtić nga Mitrovica e Veriut ka vështirësi për të gjetur punë. Por planin e saj e ka të qartë: të qëndrojë.

“Nuk besoj se diçka do të ndryshojë. Politika është siç është,” thotë Jevtić./dw

#kosove



Xhuljana Zhuleku

Gazetarje · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Më shumë opinione



OPINION

Çfarë do të thotë
kapja e Maduros për...

Xhuljana
Zhuleku 6 Jan



OPINION

Dronët ukrainas që po
godasin arkën e luft...

Xhuljana
Zhuleku 1 Dhj



OPINION

A mund të heqë dorë
Turqia nga energjia...

Xhuljana
Zhuleku 5 Tet



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.